



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



LICENCË PËR PRODHIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE

DHËNË :

MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K.

Numri i Licencës: ZRRE/Li_74/21

Prishtinë, 27 shkurt 2026

PËRMBAJTJA

Neni 1	Qëllimi	3
Neni 2	Përkufizimet	3
Neni 3	Të drejtat dhe detyrimet.....	4
Neni 4	Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Prodhimit.....	5
Neni 5	Shitja e Prodhimit dhe Ndalimi i Ndër-subvencioneve.....	6
Neni 6	Ndalimi i Abuzimit të Pozitës Dominuese	7
Neni 7	Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes dhe legjislacionin tjetër në fuqi...	7
Neni 8	Masat e efijencës.....	7
Neni 9	Dispeçingu Qendror	8
Neni 10	Shërbimet Ndihmëse dhe Balancuese	8
Neni 11	Caktimi i Operatorit.....	9
Neni 12	Rregullat e Tregut.....	9
Neni 13	Shëndeti dhe Siguria	9
Neni 14	Mjedisi.....	10
Neni 15	Puna	10
Neni 16	Regjistrimi dhe Heqja e Aseteve Relevante të të Licencuarit.....	10
Neni 17	Obligimi i Sigurimit.....	10
Neni 18	Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit	11
Neni 19	Obligimet e Shërbimit Publik	11
Neni 20	Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit.....	11
Neni 21	Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës	12
Neni 22	Taksat	12
Neni 23	Masat Administrative dhe Gjobat.....	12
Neni 24	Zgjidhja e Kontesteve.....	13
Neni 25	Hyrja në fuqi.....	13

Neni 1 Qëllimi

Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRRE (në tekstin e mëtejshëm "Rregullatori"), në pajtim me autoritetin e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Nenin 18 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017) nëpërmjet kësaj, në seancën e datës **27 shkurt 2026** ndërmarrjes **MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K.**, me adresë **Rr.Shpetim Robaj, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës (selia Shterpcë)**, i lëshon **Licencën për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë (BRE)** nga Hidrocentrali (HC) SHARRI, me kapacitet të instaluar prej **6,453 MW**, me numër licence **ZRRE/Li_74/21**, me lokacion të hidrocentralit në Shterpcë, Komuna e Shterpcës, Republika e Kosovës, (në tekstin e mëtejshëm "i Licencuari").

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:

- a) **Shërbime Ndihmëse** - të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes.
- b) **Vit financiar** - periudha prej 1 Janar deri me 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.
- c) **Njësi gjenerimi** - çdo central apo pajisje për prodhim të energjisë elektrike.
- d) **Rregulla të Tregut** – normat të cilat rregullojnë tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve në treg dhe marrëdhëniet ndërmjet palëve në tregun e energjisë elektrike, Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit të transmetimit me qëllim të mirëmbajtjes së balancit fizik të tregut.
- e) **Përgjegjësia e Balancimit** - obligimi i pjesëmarrësve të tregut që të balancojnë gjenerimin, konsumin, blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, në pajtim me oraret e pranuar, dhe të qenit financiarisht përgjegjës për jobalancet e shkaktuara.
- f) **Shërbimi i balancimit** - është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.
- g) **Konsumator fundor** - konsumatori i energjisë elektrike që blenë energjinë elektrike për përdorimin vetanë.
- h) **Legjislacion** – nënkupton Ligji për Energjinë (Ligji nr. 05/L - 081), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L - 084), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji nr. 05/L - 085) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.

- i) **Kode** - rregullat teknike të zhvilluara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në kuadër të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të aprovuara nga Rregullatori, në pajtueshmëri me Ligjin për Energjinë.
 - j) **Kontratë Bilaterale** - Marrëveshje për shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me Nenin 22, paragrafin 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptimin si shprehjet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.

Neni 3 **Të drejtat dhe detyrimet**

1. Bazuar në kornizën ligjore dhe rregullative për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) në fuqi, i Licencuari për periudhën **pesë (5) vjeçare**, duke filluar nga data e hyrjes në operim komercial, tërë energjinë elektrike do ta shesë sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë (MBE) dhe Amandamentet përkatëse të lidhura mes **MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K.** dhe **Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A.**
2. Pas skadimit të afatit sipas MBA të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, i Licencuari do të ofroj kapacitetin e tij në mënyrë transparente, jo-diskriminuese dhe të bazuar në treg, tek të gjithë konsumatorët në tregjet me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe atyre me obligimin e shërbimit publik, në përputhje me Nenin 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
3. Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe kësaj licence, i Licencuari do ta menaxhojë në mënyrë më ekonomike prodhimin e energjisë elektrike nga **HC SHARRI** dhe duhet:
 - 3.1. të përdor gjeneratorin për prodhim të energjisë në përputhje me karakteristikat teknike, kushtet mjedisore dhe legjislacionin në fuqi;
 - 3.2. të kyçë gjeneratorin elektrik në Sistemin e Transmetimit ose Sistemin e Shpërndarjes, sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara në kodet dhe rregullat përkatëse;
 - 3.3. të injektoj energji në Sistemin e Transmetimit ose Sistemin e Shpërndarjes, nën kushtet e specifikuara në kodet relevante dhe rregulloret, në pajtueshmëri me udhëzimet e operatorit relevant të sistemit;
 - 3.4. shes energjinë elektrike sipas legjislacionit në fuqi dhe në veçanti Rregullave të Tregut;
 - 3.5. blejë energjinë elektrike për nevojat e veta;

- 3.6. faturoj dhe inkasoj pagesat sipas kontratave të nënshkruara për të gjitha shitjet e energjisë elektrike, kapacitetet, shërbimet ndihmëse dhe shërbimet tjera të kontraktuara;
 - 3.7. të realizojë pagesën e duhur sipas kontratave; si dhe
 - 3.8. të kryej funksione të tjera të caktuara nga legjislacioni në fuqi dhe kjo licencë.
4. Kapaciteti nominal (i instaluar) i gjeneratorit që prodhon energji elektrike nga Burimet e ripërtërishme të energjisë nga **HC SHARRI është 6,453 MW.**

Neni 4

Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Prodhimit

1. I Licencuari do të përgatis Llogarit Vjetore në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerrë nga Rregullatori dhe do t'i dorëzoj Rregullatorit një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara, brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar. Llogaritë e brendshme duhet të jenë të ndara për aktivitetet e prodhimit nga llogaritë e brendshme për aktivitetet e tjera, sikur këto aktivitete të kryheshin nga ndonjë ndërmarrje tjetër. Në rast se i licencuari për arsye objektive nuk mund të përgatis këto pasqyra brenda tre (3) muajve, atëherë jo më vonë se 15 mars, i licencuari duhet të kërkojë nga rregullatori shtyrje afati, por jo më vonë se 30 prill për dorëzim të këtyre pasqyrave.
2. I Licencuari do të dorëzoj në Rregullator Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditori i pavarur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
3. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin gjenerues në tërësi, si dhe për aktivitetet tjera. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, dhe ndër të tjera, mund të specifikoj:
 - 3.1 formën e raporteve të bilancit financiar/regjistrave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, asetëve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktiviteteve prodhuese të konsoliduara dhe ndonjë aktiviteti tjetër;

- 3.2 natyrën dhe përmbajtjen e bilanceve financiare/regjistrave, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara;
- 3.3 parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Llogaritë rregullatore duhet të përgatiten në pajtim me parimet dhe politikat e kontabilitetit që janë shfrytëzuar për të përgatitur llogaritë statutores të të licencuarit, të përshtatura për dallimet në rastet kur parimet dhe politikat e kontabilitetit të shfrytëzuara për të përgatitur llogaritë statutores të të licencuarit dallojnë nga parimet rregullatore të kontabilitetit të përfshira në këtë kapitull.
5. Në rastet kur të licencuarit janë pjesë e një entiteti të integruar dhe mbajnë më shumë se një licencë për një aktivitet të rregulluar, ata duhet të dorëzojnë llogari rregullatore të ndara për secilën nga këto licenca.
6. Të licencuarit duhet të ndajnë aktivitetet e rregulluara dhe shërbimet e përjashtuara gjatë përgatitjes së të dhënave hyrëse rregullative. Aktivitetet e rregulluara janë ato aktivitete të ofruara nga i licencuari si pjesë e aktiviteteve të licencuara të tij, kostot e të cilave janë mbuluar nga të hyrat e lejuara maksimale sipas rregullave të çmimeve.
7. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga Rregullatori dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 5

Shitja e Prodhimit dhe Ndalimi i Ndër-subvencioneve

1. Pas skadimit të afatit të MBA të përcaktuar me Nenin 3 paragrafin 2 të kësaj Licence, i Licencuari mund të shes kapacitetin dhe/ose energjinë e tij lirshëm tek blerësit nën kushtet dhe afatet, duke përfshirë kushtet e çmimit, të vendosura:
- 1.1. në marrëveshje bilaterale ndërmjet të Licencuarit dhe blerësit; ose
- 1.2. sipas rregullave të ndonjë tregu të organizuar në të cilin i Licencuari është pjesëmarrës; përveç nëse i nënshtrohet kërkesave të kufizimit të çmimit sipas Obligimit të Shërbimit Publik të vendosur mbi të Licencuarin, sipas Nenit 19 të kësaj Licence.

2. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, i Licencuari duhet të siguroj se ngarkesat/çmimet e tij nuk janë rritur apo ulur si rezultat i marrjes apo dhënies së ndonjë ndër-subvencioni (direkt apo të tërthortë) nga ose në emër të ndonjë aktiviteti të tillë të të Licencuarit ose ndonjë personi të ndërlidhur, korporate apo ndonjë subjekti fizik apo juridik.

Neni 6

Ndalimi i Abuzimit të Pozitës Dominuese

1. Të Licencuarit i ndalohet abuzimit i pozitës së tij dominuese, siç përcaktohet në Nenin 23 të Ligjit për Energjinë dhe legjislacionit në fuqi.
2. Nëse ka dyshim për abuzim nga i Licencuari, në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni, Rregullatori do të njoftoj Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe do të vendos masa administrative dhe gjopa mbi të Licencuarin, siç përshkruhet në Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 7

Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodin e Matjes dhe legjislacionin tjetër në fuqi

I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 8

Masat e efijencës

1. Brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Licence, i Licencuari duhet të dorëzoj në Rregullator për informim, një program të masave të propozuara që do të ndërmerren për të ngritur efijencën e prodhimit nga njësitë e tij gjeneruese, në pajtueshmëri me Nenin 7, paragrafi 3 të Ligjit për energjinë elektrike dhe legjislacionit sekondar apo udhëzimet e lëshuara nga Rregullatori apo ndonjë organ tjetër kompetent.
2. Programi i masave të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të shoqërohet nga një analizë e kostove dhe përfitimeve të masave të propozuara, dhe faktorët e marrë parasysh nga i Licencuari.
3. Për aq gjatë sa Rregullatori kërkon, i Licencuari duhet t'i raportoj Rregullatorit deri më 31 dhjetor të secilit vit mbi:
 - 3.1 progresin drejt implementimit të masave të propozuara, sipas kushteve të paragrafit 1 të këtij neni, dhe
 - 3.2 përfitimet e efijencës që kanë rezultuar nga masat e implementuara.

Neni 9

Dispeçingu Qendror

1. I Licencuari do të raportoj të gjitha njësitet e gjenerimit në dispozicion tek Dispeçingu Qendror i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, kurdo që kërkohet nga Dispeçingu Qendror, sipas Kodit të Rrjetit Elektrik dhe Rregullave të Tregut.
2. I Licencuari, do t'i siguroj Operatorit të Sistemit të Transmetimit, të gjitha informacionet e kërkuara, në mënyrë që ta mundësoj operimin e sistemit të Dispeçingut Qendror, në kohën dhe mënyrën e kërkuar sipas Kodit të Rrjetit.

Në këtë Nen:

"Në dispozicion" - nënkupton njësinë e gjenerimit që është në dispozicion, në përputhje me Kodin e Rrjetit.

"Dispeçingu Qendror" – nënkupton procesin e planifikimit dhe lëshimit të udhëzimeve direkte lidhur me dispeçimin e njësive gjeneruese të disponueshme nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Neni 10

Shërbimet Ndihmëse dhe Balancuese

1. Pas skadimit të afatit të MBA të përcaktuar me Nenin 3 paragrafin 2 të kësaj Licence, I Licencuari do t'i ofroj shërbimet ndihmëse dhe shërbimin balancues nga njësitet e tij gjeneruese tek çdo operator i sistemit që kërkon shërbime të tilla në pajtueshmëri me dispozitat e kodeve të aplikueshme.
2. Kur kushtet e ofruara nga i Licencuari janë të pranueshme për Operatorin e Sistemit, atëherë palët mund të hyjnë në një marrëveshje.
1. Nëse operatori i sistemit konteston kushtet e ofruara nga i Licencuari sipas paragrafit 2 të këtij Neni, Rregullatori do të përcaktoj çdo kusht të marrëveshjes që është në mospërputhje sipas Rregullës për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
2. Nëse operatori i sistemit procedon në bazë të kushteve të përcaktuara nga Rregullatori, i Licencuari duhet të hyj në marrëveshje për shërbime ndihmëse ose shërbimin balancues dhe do ta zbatoj atë në përputhje me kushtet e saj.
3. I Licencuari, sipas kërkesës së Rregullatorit do ti dorëzoj Rregullatorit raportin me detajet si në vijim:

- 5.1. çmimet e ofruara për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe/ose shërbimet balancuese nga çdo njësi gjeneruese e të Licencuarit; dhe
- 5.2. detajet lidhur me kostot e të Licencuarit për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe / ose shërbimin balancues.

Neni 11 **Caktimi i Operatorit**

1. I Licencuari do të emëroj një person të kualifikuar dhe me përvojë përkatëse që të jetë përgjegjës për operimin e çdo njësie gjeneruese të përfshirë në licencë. Për emërimin e personit të tillë, i Licencuari duhet ta njoftoj Rregullatorin me shkrim.
2. Nëse personi nuk është kompetent që të kryej atë detyrë, Rregullatori, përmes njoftimit me shkrim dhënë të Licencuarit, mund të kërkoj zëvendësimin e atij personi.
3. Rregullatori sipas paragrafit 2 të këtij Neni, do të përcaktoj se cilat kritere do të merren parasysh në shqyrtimin e kompetencës, në përputhje me kriteret që lidhen me njohuritë dhe aftësitë profesionale, përvojën, si dhe me kriteret që lidhen me kërkesat për mbrojtje dhe sigurim të prodhimit.

Neni 12 **Rregullat e Tregut**

1. I licencuari do të veproj në përputhje me Rregullat e Tregut.
2. I Licencuari do të ketë përgjegjësi balancuese dhe do të kryej të gjitha obligimet e tij në mënyrë të shpejtë, të plotë dhe të saktë, në pajtueshmëri me legjislacionin, kodet dhe rregullat në fuqi.

Neni 13 **Shëndeti dhe Siguria**

1. I Licencuari duhet t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për t'i mbrojtur personat nga lëndimet dhe dëmtimet që mund t'u shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë ushtrimit të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, në përputhje me Legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontrolle teknike dhe të sigurisë së kapaciteteve të gjenerimit në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë do t'i dërgojë në Rregullator, sa herë që kjo kërkohet nga Rregullatori.

Neni 14

Mjedisi

1. I Licencuari do t'i dërgoj Rregullatorit kopje të Lejes Mjedisore për mbrojtjen e mjedisit dhe dokumentet tjera të lëshuara nga ministria përkatëse për mjedis. I Licencuari duhet të veproj në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë.
2. I Licencuari do t'i raportoj Rregullatorit çdo vit mbi aktivitetin e tij mjedisor.

Neni 15

Puna

I Licencuari, lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë, do të veproj në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Neni 16

Regjistrimi dhe Heqja e Aseteve Relevante të të Licencuarit

1. I Licencuari do të zhvilloj dhe mirëmbaj një regjistër të gjitha asetëve relevante dhe duhet ta dorëzoj atë në Rregullator, së bashku me ndonjë ndryshim në regjistër, jo më vonë se 31 Janari të çdo viti.
2. I Licencuari nuk do të shes apo heq dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikoj në aftësinë për ti kryer obligimet e tij apo nëse aset i ka vlerën e zëvendësimit mbi njëqindmijë euro (100,000.00 €).
3. Në rastet kur i Licencuari dëshiron të tjetërsoj asetet apo pasuritë tjera që përdoren në ushtrimin aktivitetit të licencuar, i Licencuari është i detyruar të njoftojë me shkrim Rregullatorin. I Licencuari mund të bëjë tjetërsimin e ndonjë asemi pas aprovimit me shkrim nga Rregullatori.

Në këtë Nen:

“Tjetërsim” - çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizim mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një Biznesi tjetër të të Licencuarit ose pale të tretë.

“Aset Relevant” - konsiderohet të jetë çdo pronë apo pajisje që përdoret nga i Licencuari në ushtrimin e aktiviteteve të dhëna me këtë Licencë, përfshirë çdo interes ligjor apo të dobishëm për ndonjë tokë apo objekt, dhe çdo pronësi intelektuale.

Neni 17

Obligimi i Sigurimit

1. I Licencuari do të bëjë sigurimin e asetëve në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

2. I Licencuari do të lidh kontrata për sigurimin e aseteve të gjenerimit dhe për pajisjet që përdoren për prodhim të energjisë elektrike. Kontratat e tillë do t'i dërgohen Rregullatorit për rishikim sa herë që i kërkon Rregullatori.

Neni 18

Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

1. I Licencuari do të njoftoj Rregullatorin për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll, së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa nuk aprovohet nga Rregullatori.
2. I Licencuari do të njoftoj Rregullatorin për çdo ndryshim të strukturës organizative të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i dërgohet Rregullatorit jo më vonë se tri (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

Neni 19

Obligimet e Shërbimit Publik

I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimit publik që mund t'i vendoset nga Rregullatori, në përputhje me Nenin 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 20

Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit

1. I Licencuari do t'i dorëzoj Rregullatorit informacione, raporte dhe kontrata në mënyrën dhe në afatet që Rregullatori mund t'i konsideroj të nevojshme.
2. I Licencuari do të dorëzojë në Rregullator raporte mbi veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe pajtueshmërinë me kushtet Licencës, në pajtim me Doracaku e Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga Rregullatori, si dhe kërkesave të Rregullatorit.
3. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale, kërkon që ndonjë informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial, atëherë është i obligim i tij që të shënjoj atë informacion si konfidencial dhe të arsyetoj kërkesën e tij në Rregullator. Rregullator do të shqyrtoj kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
4. I Licencuari do të raportoj në Rregullator, sa herë që kërkohet, lidhur me rrethanat e shitjes tek blerësit, duke përfshirë (pa kufizim) volumet, faktorët e ngarkesës, kushtet e përfundimit, afatet dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve përkatëse.
5. I Licencuari do të emëroj një person kryesor përmes të cilit do të ketë lidhje komunikimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Tregut. Adresa, numri i telefonit, numri i faksit ose adresa elektronike e personit të tillë do t'i dërgohen Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut.

6. I Licencuari duhet t'i dorëzoj Rregullatorit detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

"Informacioni" - materiali që në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshij çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga Rregullatori.

Neni 21

Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. Rregullatori mund të vazhdoj, modifikoj, pezulloj dhe ndërpres këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. Rregullatori mund të transferoj këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke u siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

Neni 22

Taksat

I Licencuari do t'i paguaj Rregullatorit çdo taksë fillestare dhe vjetore të caktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga Rregullatori.

Neni 23

Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi përfshirë Rregullat e nxjerra nga Rregullatori apo Nenet dhe kushtet e kësaj Licence apo udhëzimet e dhëna të Licencuarit nga ana e Rregullatorit, Rregullatori ka kompetenca që t'i vendos të Licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 57 të Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 24
Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me dispozitat e MBA-së apo Rregullës për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga Rregullatori.
2. Vendimet e Rregullatorit lidhur me ndryshimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.

Neni 25
Hyrja në fuqi

1. Në pajtim me Nenin 32 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë (me numër licence **ZRRE/Li_74/21**), i lëshohet ndërmarrjes **MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K.** për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (uji) dhe hynë në fuqi me datë **27 shkurt 2026**.
2. Kjo Licencë do të jetë e vlefshme për një periudhë **katërdhjetë (40) vjeçare**, deri me **26 shkurt 2066**.
3. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për **MATKOS GROUP HC SHARRI SH.P.K** (NUI 810857758) të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me:



Nënshkruar (në emër të Bordit të Rregullatorit) **Ymer Fejzullahu, kryesues i bordit:**

Nënshkruar më: 27.02.2026.

Fundi i dokumentit